

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni civil si gjykatë e shkallës së parë e përbërë nga gjyqtari Binak Duqi me sekretaren juridike Xhevide Selmani, ne çështjen juridike të paditëses së mitur: E.H., të cilë ne përfaqëson i ati Sh. H., nga fshati L. i P. e që të dy i përfaqëson i autorizuari Z. I. avokat nga P. me autorizim, kundër të paditurës KS “E.” nga Prishtinë të cilën e përfaqëson I. B. me autorizim, për zhëmtim, në seancën publike në praninë e të autorizuarit të paditëses dhe përfaqësuesit të paditurës me dt. 18.09.2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. PJESËRISHT MIRATOHET** kërkesëpadia e paditëses së mitur E. H. nga L. i P. Komuna e P.
- II. DETYROHET** e paditura KS. “E.” nga P. që paditëses së mitur për lëndimet e rënda trupore të pësuar në fatkeqësi të komunikacionit me dt. 15.07.2010, në rrugën Prishtinë- Podujevë, në fshatin L. i P. nga automjeti i udhëtarëve Fiat Uno me targa *numër i targave...* i siguruar tek paditura që t`ia paguaj dhe atë:
- A. Për dëmin jo material.
1. për dhimbje fizike shumë prej 2500 €.
 2. për frikë shumë prej 1500 €.
 - 3 për shëmtim trupor në shkallë të ulët 500 €.
 4. për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallën prej 10% shumë prej 3000 €.
- B. Për dëmin material **REFUZHET** si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses së mitur për këto kritere:
5. për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shuma prej 70 €,
 6. për ushqim të përforcuar shuma prej 100 €.
- Gjithsejtë shuma e aprovuar për paditësin e mitur është 7500 €, si e **BAZUAR**. Përtej shumes së aprovuar prej 7500 €, refuzohet si e pabazuar shuma prej 6170 €, për dëmin jo material dhe material.
- A/B.
- Detyrohet** e paditura KS “E.” që shumë prej 7500 €, të ia paguaj paditëses së mitur me kamatë si që e paguajnë bankat afariste të Kosovës për mjete të deponuara mbi një vit, pa destinomë të caktuar duke fillua prej dt. 18.09.2013, e gjerë në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.
- Detyrohet e paditura që paditëses të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 650 € në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja e mitur E. H. e përfaqësuar nga përfaqësuesi i sajë ligjor- babai Sh. H. e që të dy të përfaqësuar nëpërmes të autorizuarit të tyre avokati Z. I. nga P., në padi, precizim të kërkesëpadiës si dhe në seancat e mbajtura në gjykatë ka deklaruar se me dt. 19.07.2010, ka ndodhur fatkeqësia e komunikacionit me që rast lëndime të rënda trupore ka marrë paditësja e mitur E. e lindur me *viti i lindjes...*, në fshatin L. i p.. Fatkeqësia është shkaktuar kur ngasësi i veturës Fiat Uno, me targa *numër i targave...*, si ngasës ishte Sh. Zh. duke qarkulluar me veturën e tij në drejtimin Prishtinë-Podujevë, kur arrin në fshatin L. i P. pa i përshtatur shpejtësinë e kushteve të rrugës e që shpejtësia ishte e kufizuar 50 km/H, edhe pse e ka vërejtur këmbësorin duke kaluar rrugën për shkak të shpejtësisë së madhe e që kishte 22 metra frenim që vërehet nga gjurmët nuk arrin ta ndalë automjetin dhe me pjesën e parë të majtë e godet këmbësorin

paditësen e mitur në këmbën e djathtë dhe e gjuan në parafango e prej aty në tokë. Duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore. Si pasojë e këtij aksidenti ajo ka përjetuar dhe frikë, shëmtim, si dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë.

I autorizuari i paditëses e ka bërë rregullimin dhe precizimin e kërkesëpadisë në seancë ne dt. 18.09.2013, duke deklaruar se në raportin e emergjencës QKUK nr. 23094, dt. 18.07.2010, rrjedh një gabim teknik sepse në te duhet të jetë data 15.07.2010 e kjo vërtetohet me faktin se fletlëshimin me nr. Të historisë nr. 11087 lëshuar nga klinika e ortopedisë e mban datën 16.07.2010, deri me 17.07.2010. me diagnozë të nyejt atë të Qendrës Emergjente të QKUK. Të njëjtat gabime teknike nuk i ka kontestua as përfaqësuesi i të paditurës nga se sipas tij edhe bashkudhëtarja H.S.e cila e ka realizua dëmin pranë të paditurës ishte e pranuar në spital me 16.07.2010, dhe si provë ia dorëzoj gjykatës një kopje nga klinika gjinekologjike obstetrike me nr. Të amzës 9247, sipas vërtetimit të dt. 19.07.2010.

I ka propozuar gjykatës që ta aprovoi padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar si të bazuar në tërësi si nga baza ashtu edhe nga lartësia e sajë.

Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigje në padi në seanca dhe fjalë përfundimtare nuk e ka kontestua bazën juridike të kërkesëpadisë por lartësinë e tyre. Dhe me atë rast i bëri paditëses së mitur ofertën prej 6000 € për kompensim demi kurse përtej shumës së bërë si ofertë i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e sajë si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Nisur nga kjo gjendje gjykata për të vërtetua drejt këtë çështje kontestimore bëri administrimin dhe leximin e provave një nga një e të gjitha së bashku konformë nenit 8 të LPK-së. Dhe vërtetoi këtë gjendje faktike:

Meqenëse nuk është kontestuese baza juridike në këtë çështje civile juridike, mirëpo vetëm lartësia e sajë atëherë gjykata bëri marrjen e provës me dëgjimin e ekspertëve mjekoligjorë dr. V. B.ortopede dhe dr. V. A.- S. psikiatër pranë QKUK Prishtinë.

Ekspertja dr. V. B. ortopede në mendimi ne sajë të hënë me dt. 15.07.2013, me shkrim lidhur me natyrën dhe llojin e lëndimeve për paditësen e mitur të pësuar në këtë aksident ka deklaruar se ajo ka pësuar këto lëndime: plagë shqyese në regjionin e kofshës së djathtë dhe frakturë e humerusit të djathtë duke i cilësuar lëndimet e saja si lëndime të rënda trupore.

Më tutje shton se paditësja ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 1 orë deri në marrjen e ndihmës së parë , dhimbje fizike të intensitetit të rëndë 2 ditë të shoqëruara me dhembje të krahut pas intervenimit kirurgjikal, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 30 ditë, dhe ati të ulët 3 muaj.

Paditësja ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallë prej 10%, e shprehur në zvogëlimin e lëvizjes së nyjës së bërrylit të djathtë në shkallë të lehtë. Po ashtu ajo ka shëmtim trupor të shkallës së ulët- vraga pas intervenimit kirurgjikal në krahun e djathtë dhe aed në pjesë ne sipërme të krahut me gjatësi 4 dhe 2 cm dhe pjesën e jashtme të krahut të djathtë me gjatësi 2 cm, vraga në kofshën e djathtë me gjatësi 6 cm.

E njëjta ka pas nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 3 javësh si dhe për ushqimin të përforcuar për një muaj dhe terapi fizikale në kohëzgjatje prej 3 javësh.

Sa i përket frikës së përjetuar të paditëses ekspertja dr. V. A. S., psikiatër në mendimin e sajë të dhënë me 15.07.2013, ka deklaruar se paditësja ka përjetuar frikë sekondare kurse e përjashton frikën primare sepse ajo nuk është ballafaquar direkt me ndjenjën e përfundimit fatal d.m.th. frikën nga vdekja pasi që ka qenë errësirë dhe nuk e ka pa momentin e aksidentit. Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 3 orë, nga momenti i aksidentit deri te dërgimi në QKUK, kur iu ka ofrua ndihma, dhe janë ndërmarrë veprimet tjera mjekësore, frikë sekondare të intensitetit mesatar 2 muaj e manifestuar me ankthe, siklet, inkontinenc emocionale si dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila ka zgjat 6 muaj e paraqitur me ankthe, gjumë jo të rehatshëm, tmerret e natës, ankesa somatike (dhembje krahut, këmbës), etj.

Pala paditëse pas mendimit të dhënë e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar këto shuma për kompensim të dëmit jo material dhe material për paditësen e mitur E. H..

Për dhimbje fizike ka kërkuar 4000 €, për frikën e përjetuar shumë prej 3000 €, për shëmtim truporë shumë prej 1500 në shkallë të ulët, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë shkalla 10%, dhe e moshës 20 vjeçare, shumë prej 5000 €, për dëmin material në emër të ndihmës së personit të tretë shumë prej 70 €, për tri javë të nevojitur , për ushqim të përforcuar për 1 muaj 100 €. E gjithsejtë shuma e kërkuar është 13.670 €

Gjykata pas dëgjimit të palëve ndërgjyqësve, ekspertëve mjekoligjorë të ortopedisë dhe psikijatris si dhe provave tjera të administruara në procedurë gjeti dhe i aprovoi paditëses së mitur E. H. këto shuma.

Për dhimbje fizike shumë prej 2500 €, për frikë 1500 €, për shëmtim trupor në shkallë atë ulët 500 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë shkalla 10% shuma prej 3000 €, kurse sa i përket kërkesave për dëmin material dhe atë për ndihmë ne personit të tretë shumë prej 70 €, dhe për ushqim të përforcuar shumë prej 100 €, gjykata i refuzoi si të pabazuara dhe të pa provuara gjatë procedurës sepse pala paditëse nuk arriti me provua se vërtetë pala paditëse ka shpenzuar të holla për këto dy kriterë dhe kush i ka ofruar ndihmë paditëses pra personi i cili i ka dhënë ndihmën.

Shumat e aprovuara për paditësen e mitur janë të bazuara në mendime të eksperteve mjekoligjorë, me natyrën dhe llojin e lëndimeve , frikën e përjetuar dhe gjykata i aprovoi shumat të cilat janë atë cekura në diapozitiv të aktgjykimit duke besuar se ato shuma janë satisfacioni më real me atë çka ka pësuar paditësja e mitur. Këto shuma të aprovuara janë po ashtu si kompensim real me të mirën e shkelur për paditësen dhe të njëjtat janë të bazuara dhe në nenin 200 al.1. dhe 2 të LMD, duke pas parasysh parimin që kompensimi të jetë sa më i drejtë, rëndësinë e të mirës së shkelur, qëllimin që i shërben ky kompensim si dhe fakti që kompensimi të mos i shkoi përshtati synimeve të cilat nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe qëllimin shoqërorë, pjesërisht pati parasysh kriteret e kompanive të sigurimeve të miratuara nga e paditura , praktikën gjyqësore si dhe bindjen e lirë të gjyqtarit.

Gjykata pati parasysh kundërshtimin e përfaqësuesit të paditurës sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë të kërkuara në precizimin e sajë dhe të njëjtën kohë vlerësoi edhe ofertën e të paditurës në shumë prej 6000 €, që deri diku ishte reale me lëndimet e përjetuara të paditëses, mirëpo gjykata duke pas parasysh moshën e paditëses së mitur 20 vjeçare dhe lëndimet e cilësuar nga ekspertët atëherë gjykata është e mendimit se shumat e aprovuara janë satisfacioni më real për rastin konkret edhe pse nuk e nënvlerësoj ofertën e të paditurës.

Gjykata i vlerësoi edhe shumat e kërkuara nga pala paditëse në precizimin e bërë të kërkesëpadisë duke i cilësuar si të larta dhe jo në harmoni me lëndimin e pësuar të paditëses natyrën dhe llojin e lëndimeve si dhe frikën e përjetuar të sajë, por këto shuma të kërkuara nuk ishin në harmoni as me nenin 200 al.1. dhe 2 të LMD, parimet e tij që i kërkon , praktikën gjyqësore, si dhe kriteret e kompanive të sigurimeve e që gjykata për afërsisht i pati parasysh si të tilla. Po ashtu parimin e pati parasysh që njëra palë të pasurohet njëra palë mos të pasurohet pa bazë dhe pala tjetër të dëmtohet pa masë në këtë rast e paditura.

Meqenëse nuk ishte kontestuese baza juridike por vetëm lartësia e sajë dhe se aksidenti është shkaktua me fajin e të siguruarës së të paditurës i cili e ka pas të siguruar automjetin e tij tek e paditura me polisë të sigurimit valide me nr. 0002357875, e vlefshme deri me 02.09.2010, atëherë paditura mban përgjegjësinë për kompensimin e dëmit për lëndimet pësuar të paditëses së mitur dhe për dëmin e shkaktuar asaj pasi që e njëjta nuk u kontestua as nga përfaqësuesi i të paditurës qoftë në përgjigje në padi por as në seancat e mbajtura atëherë në kuptim të nenit 321.2 të LPK thuhet se nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësorë dhe në këtë drejtim gjykata nuk i vlerësoi ato prova të cilat i argumentojnë këto fakte pasi që nuk ishin kontestuese për palët ndërgjyqëse.

Gjykata po ashtu lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit të shumave të aprovuara të cilat janë të cekura në dispozitiv të aktgjykimit u mbështet në nenin 200 të LMD, lidhur me nenin 323 të LPK-së, mendimin e ekspertëve mjekoligjorë, pjesërisht kriteret e kompanive të sigurimeve, praktikën gjyqësore dhe gjykata në këtë rast e vlerësoi se kompensimi i dëmit jo materialë për paditësen e mitur nuk është ndoshta i plotë por është satisfacioni për të më real i mundshëm dhe se shumat e gjykuara janë të drejta për paditësen.

Andaj pa dyshim u vërtetua nga provat e administruara se lëndimet e paditëses së mitur janë rezultat i aksidentit dhe ekziston lidhja kauzave e lëndimeve me rastin e siguruar dhe e paditura mban përgjegjësinë për kompensim dëmi si që e kanë parapa kriteret e kompanive të sigurimeve të cilat janë të miratuara nga vet e paditura, me rregullin 3 të BQK si dhe nenit 200 LMD.

Pjesa refuzuese për dëmin material dhe atë për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë gjykata i refuzoi ato për faktin se me asnjë provë nuk u argumentua bazueshmëria e tyre, lartësia e shpenzimeve të bëra duke i ofruar gjykatës fatura dhe tregua secili person i ka ndihmua paditëses deri sa ka qenë e lënduar si që e parasheh neni 3 i LPK, ku thuhet se pala paditëse ka për detyrë të paraqes faktet mbi të cilat i mbështetë kërkesat e veta dhe të propozoj prova në të cilat konstatohen ato fakte. Shumat e aprovuara për paditësen gjykata i bëri konform neneve 154,155,173,174 dhe 200 të LMD, kurse refuzoi shumën tjetër si të pabazuar dhe të pavërtetuar në procedurë me prova nga paditësja si që u cek në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në dispozitat e nenit 449,450,452.2 dhe 453 të LPK, duke pas parasysh që paditësi pjesërisht pati sukses në kontest andaj asaj pjesërisht ju pranuan edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 650 €, dhe atë për përpilimin e padisë shpenzimet e ekspertëve mjekoligjorë në shumë prej 200 €, dhe për taksë gjyqësore 100 €, 50 € për padi dhe 50 € për aktgjykim si dhe shpenzimet për përfaqësimet e të autorizuarit të sajë për 3 shqyrtime sipas TA të tetorit 2011 neni 7.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË- DEGA PODUJEVË
C.nr.415/10/10. të dt.18.09.2013.

Gjyqtari:
Binak Duqi

KESHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar
Ankesa në afatin prej 15 ditësh, prej ditës
së marrjes së një kopje Gjykatës së Apelit
Prishtinë, përmes kësaj gjykate.